


# BIOLOGJIA ONLINE / FAKTORET EKOLOGJIK

Faktoret biotik


Faktoret abiotic

Faktoret antropogjen



Deri tek te gjith, per te sensibilizuar panikun dhe friken ,mos u shqetesoso ka masa preventive ,laji duart,fytyren ,vendo maske,doreza ,konsumo vitamin C ,D ,minerale,mg, cink,,pastro vendet ku qendron cdo dite,dizinfekto ☺

## **PERSHENDETJE TE DASHUR NXENES !**



**Duke pasur parasysh situaten e jashtezakonshme ne shtetin ton ,detyrimisht ne duhet te qendrojme ne shtepit tona,dhe me vetedije dhe ndergjegje te plote ti zgjedhim hapat e duhura dhe ti respektojme urdherat ashtu sic na kan rekomanduar institucionet shteterore ,dhe mos u be shkak I te keqes ?!**  
**Mirepo edhe pse jemi ne shtepi neve nuk na pengon azgje,dhe mundemi te krijojme kushte te pershtatura per te vazhduar se nxenuri dituri tek cdo nxenes,student,,tek ju si shtylla kryesore e shoqerise. Dhe nga ju kerkoj vemendjen tuaj,dhe bashkepunimin tuaj, dhe sebashku do te arrijme sukseset e deshiruara dhe te parapara ne plan programet tona si mesimdhenes dhe pse jo zgjerimin e njohurive dhe shkathtesive te reja tek ju ne diapazonin me te ri te diturise **ONLINE**.**

**Ju mirepres me knaqesi :FILLOJME:**

**Hapi I pare ,shfletimi I sllajdeve te derguara nga ana e mesimdhenesit,shqyrtimi I tyre.**

**Hapi I dyte ne bashkengjithe te sjllideve do te keni flete pune ,te cilen duhet ta punoni dhe te me riktheni te plotesuar**

**Hapi I trete vlersimi , bashkengjitje live/video per komunikim te hapur .**

# FAKTORET ABIOTIK

## DRITA

- Drita diellore është burim kryesorë i energjisë për numrin më të madh të organizmave fototrof. Bimët mund ta absorbojnë vetëm atë dritë që e pranon aparati klorofilian.
- **Heliofite** janë bimë që jetojnë në vende me ndriçim intenziv, ndërsa
- **Skiofitet** janë bimë të cilat preferojnë vendbanimet e hijësuara
- **TEMPERATURA**
- Ndryshimet e temperaturës janë të kshtëzuara nga zonat klimatike të Tokës dhe shfaqja e lartësive malore, të cilës i korespondon përhapja zonale e organizmave. Sipas dallimeve të temperaturës, zonat e Tokës duke filluar prej ekuatorit ndahen në beza: ekuatorial, tropik, subtropik, mesatarë dhe polarë.
- Organizmat tropik dhe subtropik rriten vetëm në temperatura vazhdimisht të larta dhe quhen **lloje termofile**. Për dallim prej tyre një numër i madh i bimëve dhe shtazëve të zonës së mesme rriten edhe në temperatura afër zeros dhe quhen **lloje psikrofile**.



## UJI

Uji është faktori ekologjik themelorë për të gjithë orga- nizat e gjallë. Për rëndësinë e ujit për botën e gjallë dihet mirë, si dhe ajo se pa ujin jeta në Tokë nuk do të ekzistonte.

**Hidrofite:** bimët që janë përshtatur jetës në mjedisin ujorë.

**Higrofite :** bimë të përshtatura për jetë në mjedise me lagështi.

**Mezofite:** bimë që vegjetojnë në toka me lagështi mesatare, si në brezat tro- pik ashtu edhe në brezat e ftohtë.

**Xserofitet:** janë bimë të përshtatura në kushte ekstremisht të pavolitshme me lagështi minimale.

## AJRI

Përbërja e ajrit ka ndikim të madh në zhvillimin e organizma- ve. Në përbërjen e pjesës së ajrit atmosferik hyjnë azoti (78%), oksigjeni (21%), argoni (0,9%), dioksidi i karbonit (0,03%) dhe avulli i ujit (1%). Të gjithë gazrat në mënyrë të barabartë janë të rëndësishëm për jetën normale të organizmave dhe qarkullimin e materjes në natyrë.



## TOKA


Toka si faktorë ekologjik, paraqet sipërfaqen shkëmbore të grimcuar, me përbërje komplekse, e përzier me mbetjet e bimëve dhe shtazëve të zbërt- hyera, në të cilën vegjetojnë bimët (rriten bimët), kurse jetojnë edhe disa grupe të mikroorganizmave dhe shtazëve. Zhvillimi i bimëve dhe formimi i tyre është ngushtë i lidhur për sipërfaqen e tokës, nga e cila i marrin materjet minerale dhe ujin. Bimët e ndryshme vegjetojnë në tipe të ndryshme të tokës



## NIVELET DHE ZINXHIRËT E TË USHQYERIT

*Zinxhiri ushqimorë paraqet renditjen lineare të organizmave sipas tipit të të ushqyerit të tyre, ku çdo anëtarë përfaqëson hallkë me vend saktësisht të përcaktuar në zinxhirë dhe është i lidhur me hallkën tjetër, e cila gjendet para dhe pas tij.*

Sipas raporteve midis niveleve trofike (hallkat që e përbëjnë zinxhirin ushqimorë), zinxhirët mund të ndahen në tre grupe kryesore:



## Zinxhiri ushqimor I grabitqareve

- bimët e gjelbërta
- herbivorët
- mishngrënësit
- grabitësit me masë trupore më të madhe

## Zinxhiri ushqimor I paraziteve

- bimë
- herbivori
- parazitët

## Zinxhiri ushqimor I saprofiteve

- materia e vdekur organike
- insektet e imëta
- shpërbërësit bakterial



PRODHUESIT



KONSUMA-  
TORËT E PARË  
(HERBIVORË)



KONSUMA-  
TORËT E DYTË  
(OMNIVORË)




SHPERBERESIT



## PRODHUESIT

***Organizmat autotrof***, të cilët kryejnë fotosintezën janë producent (prodhues) në zinxhirin e ushqimit. Ato prodhojnë ushqim për të gjithë organizmat e gjallë.








## KNSUMATORET


Organizmat që ushqehen me prodhues quhen konsumatorë. Ato janë **orga- nizma heterotrof**. Sipas vendit të tyre në zinxhirin ushqimorë, ato mund të jenë: konsumatorë primarë, sekondarë terciarë ose kuatërnarë. Sipas ushqimit që e konsumojnë ndahen në disa grupe: **herbivorë** (ushqehen vetëm me organizma autotrof), **karnivorë** (shtazë mishngrënëse), dhe **omnivorë** (hanë edhe ushqim bimorë edhe shtazorë).



## SHPËRBËRËSIT (DEKOMPOZUESIT)



Këtu bëjnë pjesë ***kërpudhat dhe bakteriet*** të cilat e shpërbëjnë zërthejnë) materjen organike prej bimëve dhe shtazëve. Produktet nga shpërbërja janë azo- tike, karbonike, fosforike si dhe bashkëdyzime dhe elemente tjera. Organizmat autotrof i shfrytëzojnë këto materie nga toka dhe i përdorin për prodhimin e ushqimit të ri. Ciki i këtillë pandërprerë ndodhë në ekosistem.



## ZINXHIRI USHQIMOR

*Zinxhirët e ushqimit kanë disa veti të rëndësishme. Secili anëtarë i ardhshëm në zinxhirin e ushqimit është më i madh se anëtari paraprak. Ndërsa proporcioni i kundërt, me numër më të madh të organizmave karakterizohen anëtarët e fillimit në zinxhirin e ushqimit, kurse me numër më të vogël anëtarët e fundit. Ajo është e rregulluar reptësisht, kështu që çdo anëtarë i mëparshëm në zinxhirë me numrin e tij siguron mbijetesën e antarit në vijim, numri i individëve të cilët duhet të jetë më i vogël. Me këtë organizmat njëkohësisht sigurojnë edhe mbijetesën e tyre*

